



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E FINANCA VE**  
**DREJTORIA E PERGJITHSHME E DOGANAVE**  
**DEPARTAMENTI I AKCIZES**

**UDHEZIM**

Nr. 2, date 27.09.2012

**Mbi percaktimin e mases se garancise per magazinat fiskale te prodhimit/perpunimit, stokimit dhe ne levizjen e mallrave te akcizes nen pezullim**

Ne zbatim te neneve 21 deri 29 dhe 108 te ligjit 61/2012 "Per akcizat ne Republiken e Shqiperise", si dhe neneve 72 deri 76 te VKM nr. 612 ,date 05.09.2012, "Per dispozitat zbatuese te ligjit per akcizat "Drejtori i Pergjithshem i Doganave;

**UDHEZON:**

I. Ne zbatim te nenit 22 pika 1, te ligjit 61/2102, "Per akcizat ne Republiken e Shqiperise", dhe nenit 75 pika 1, germa (a), te VKM nr. 612, dt. 05.09.2012, "Per dispozitat zbatuese te ligjit per akcizat", me qellim marrjen e statusit te depozituesit te miratuar dhe te magazines fiskale te stokimit autoritetet doganore kerkojne depozitimin e nje garancie per te mbuluar dy ose me shume veprime per te cilat mund te lindi nje borxh ne masen 100% te detyrimeve te llogaritura te akcizes per produktet e depozituara.

2. Ne zbatim te nenit 22 pika 2, te ligjit 61/2102"Per akciza ne Republiken e Shqiperise" dhe nenit 73 pika 1, te VKM nr. 612, dt. 05.09.2012 "Per dispozitat zbatuese te ligjit per akcizat", me qellim marrjen e statusit te depozituesit te miratuar dhe te magazines fiskale te perpunimit/prodhimit, autoritetet doganore kerkojne depozitimin e nje garancie per te mbuluar dy ose me shume veprime per te cilat mund te lindi nje borxh akcize.

3. Percaktimi i mases se garancise per qellime te pikes 2 te ketij udhezim me perjashtim te produkteve energjitike, behet sipas perqindjeve te percaktuara ne tabelen e meposhtme, bazuar ne shumen e detyrimeve te akcizes per teresine e produkteve qe i nenshtrohen detyrimeve te akcizes te prodhuara ne magazinën fiskale te prodhimit/perpunimit gjate vitit p araardhes ose te parashikuara per tu prodhuar gjate nje viti.

Tabela e mases se garancise se kriterëve:

Masae garancise	Kriteret per percaktimin e nivelit ne % te mases se garancise
-----------------	---

5%	<p>Prodhuesit/perpunuesit e konsoliduar (me qendrueshmeri ne treg per me shume se 5 vjet) dhe pa historik shkeljesh ne fushen e akcizes.</p> <p>b.Vjeteruesit e produkteve alkoolike pa historik shkeljesh ne fushen e akcizes.</p> <p>c..Prodhuesit e birres (B 000) me nivel prodhimi <math>\geq</math> se 200 000 HI/vit, pa historik shkeljesh ne fushen e akcizes.</p> <p>d. Prodhuesit e virres (V200) me nivel prodhimi <math>\geq</math> se 10 000 HI/vit, pa historik shkeljesh ne fushen e akcizes.</p> <p>e.Prodhuesit e pijeve alkoolike (kategoria S200) me nivel prodhimi <math>\geq</math> 20 000 HI/vit, pa historik shkeljesh ne fushen e akcizes.</p>
7%	<p>a.Prodhuesit/perpunuesit me veprimtari me pak se 5 vjet dhe pa historik shkeljesh ne fushen e akcizes.</p> <p>b. Prodhuesit e birres (B 000) me nivel prodhimi <math>&lt;</math> se 200 000 HI/vit, pa historik shkeljesh ne fushen e akcizes.</p> <p>c. Prodhuesit e veres ( V 200) me nivel prodhimi <math>&lt;</math> se 10 000 HVvit pa historik shkeljesh ne fushen e akcizes.</p> <p>d.Prodhuesit e pijeve alkoolike (kategoria S200) me nivel prodhimi <math>&lt;</math> 20 000 HI/vit pa historik shkeljesh ne fushen e akcizes.</p>
10%	<p>a. Prodhuesit/perpunuesit e produkteve te akcizes te cilet kane kryer 1 here shkelje ne fushen e akcizave</p> <p>b.Vjeteruesit e produkteve alkoolike te cilet kane kryer 1 here shkelje ne fushen e akcizave</p>
15%	<p>a. Prodhuesit e rinj qe fillojne aktivitetin per here te pare.</p> <p>b. Prodhuesit/perpunuesit e produkteve te akcizes te ciletjane recitivist (me shkelje te perseritur me shume se 1 here )</p>

4. Ne rastet e prodhimit/ perpunimit te produkteve alkoolike te ndryshme (kombinuara), masa e garancise perlloraget si shumatore e secilit produkt masa e garancise se te cilit perlloragete bazuar ne kriteres e tabelës se dhe ne piken 2 me lart.

5. Masa e garancise per produktet energjitike percaktohet sipas nenit 22, pika 5 te ligjil 61/2102, "Per akcizat ne Republiken e Shqiperise" dhe neneve 73 pika 2 dhe 75, pika 1 germa (c) te VKM nr. 612, dt. 05.09.2012, "Per dispozitat zbatuese te ligjit per akcizat".

6. Ne zbatim te nenit 22 pika 3, te ligjit 61/2102, "Per akcizat ne Republiken e Shqiperise", dhe nenit 75 pika 1, germa (b) te vkm nr. 612, dt. 05.09.2012, "Per dispozitat zbatuese te ligjit per akcizat" shuma e garancise qe duhet paraqitur per te mbuluar rreziqet qe kane te hejne me

produktet ne levizje me pezullim duhet te perkoje me 100% te detyrimeve te llogaritura te akcizes.

7. Per qellime te nenit 23, pika 4 te ligjit 61 /2012 "Per akcizat ne Republiken e Shqiperise", institucionet buxhetore te cilet aplikojne per te marre statusin e depozituesit te miratuar perjashtohen nga detyrimi per te depozituar garanci per qellime te marrjes se autorizimit te magazines fiskale. Konfirmimi nese aplikuesi per depozitues te miratuar eshte apo jo insitucion buxhetor merret ne Ministrine e Financave. Ndryshimi i statusit si institucion buxhetor sjell ndryshimin e mases se garancise.

8. Format i garancise se paraqitur nga shoqerite aplikuese duhet te plotesoje kriteret e percaktuara ne nenin 76 te VKM nr. 612, dt. 05.09.2012, "Per dispozitat zbatuese te ligjit per akcizat". Administrata Doganore duhet te verifikoje nese format i paraqitur i garancise eshte sipas aneksit 22 te ketij vendimi ne te kundert e kthen ate mbrapsh si te papranueshem. Autoritetet doganore informojne aplikuesin per kete qellim duke i vene ne dispozicion edhe nje kopje te formatit te kerkuar.

9. Ne rastin e paraqitjes se formatit te garancise nga Shoqerite e Sigurimit, edhe ne rast se ky i fundit eshte ne perputhje te plote me aneksin 22 te VKM nr. 612, date. 05.09.2012, "Per dispozitat zbatuese te ligjit per akcizat", autoritetet doganore kryerjen konfirmimin e besueshmerine se garancise dhe te shoqerise garantuese prane Autoritetit te Mbikqyrjes Financiare. Ne rast konfirmimi te mosbesueshmerine se garancise nga ky autoritetet, ne rast se autorizimi eshte leshuar, behet menjehere pezullimi i tij dhe kerkohet garancia e rregullt nga nje ent tjeter i besueshem garantues. Autorizimi mbetet i pezulluar deri ne plotesimin e formatit te pranuar te garancise nga depozituesi i miratuar, pritesa apo dergues i regjistruar. Ne rast se ky format nuk depozitohet behet revokimi i autorizimit te meparshem.

10. Ky udhezim hyn ne fuqi menjehere

**Flamur GJYMISHKA**

**DREJTOR I PERGJITHSHEM**